

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rrethi i vogël shoqëror nuk është gjithmonë vetmi: çfarë kuptimi merr mendimi që lidhet me Sokratin
ADRESA	https://albeu.com/lifestyle/rrethi-i-vogel-shoqeror-nuk-eshte-gjithmone-vetmi-cfare-kuptimi-merr-mendimi-qe-lidhet-me-sokratin/1029133/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 06:54:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 06:49:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dc3fa0fc9aad706520a527c5e6c4feb5a0d120c74f109daa79d4270c36a1c584
TEKSTI	00ed837b5bfd63f72b9b1417cf0d64ca2d9f0dfadb3b03f04633fef4c7b7ba1c
PAMJA	b3b25e62413a05e34dcc007c6ab1fb2af2c4a40829766ba2fb37bf4f7ca35e81

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ae7b30b3a230a670b5a1f4b0faf116399a737656a7f727e67c55a1d559d4e2c4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f5063896df89cef7c197e5d003e6be2f1d9963e4417c199c978c5a8c380b40e8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ae7b30b3a230a670b5a1f4b0faf116399a737656a7f727e67c55a1d559d4e2c4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Rrethi i vogël shoqëror nuk është gjithmonë vetmi: çfarë kuptimi merr mendimi që lidhet me Sokratin



Me kalimin e moshës, nevoja për shoqëri nuk zhduket, por ndryshon mënyra se si vendosim kujt t'i japim besimin dhe kohën tonë.

Sokrati, një prej figurave më të rëndësishme të filozofisë së Greqisë së lashtë, ndikoi thellë në historinë e mendimit, ndonëse nuk la pas shkrime të tijat. Pikëpamjet e tij u përcollën përmes nxënësve dhe autorëve të tjerë të antikitetit, veçanërisht Platonit.

Në hapësirën online qarkullon një shprehje që i atribuohet atij: "Nëse një njeri ka pak miq, do të thotë se ka shumë përvojë jetësore."

Nuk dihet me siguri nëse kjo fjali është vërtet autentike, por mesazhi i saj ngre një çështje me interes: a mund të jetë një rreth i kufizuar miqsh shenjë e përvojës së fituar dhe jo medoemos e vetmisë?

Përvojat përcaktojnë kujt i besojmë

Gjatë jetës, njerëzit përballen me lloje të ndryshme marrëdhëniesh. Disa miqësi zgjasin për shumë vite, disa të tjera mbyllen gradualisht, ndërsa të tjera marrin fund për shkak të zhgënjimit, tradhtisë ose zbulimit se palët nuk kanë më të njëjtat vlera.

Këto përvoja na ndihmojnë të kuptojmë dallimin mes një lidhjeje të singertë dhe një njohjeje që mbetet vetëm në sipërfaqe.

Pas disa zhgënjimeve, bëhet më e qartë se prania e shumë njerëzve përreth nuk nënkupton automatikisht se kemi shumë miq të vërtetë. Me kohën, besimi, mirëkuptimi, singjeriteti dhe respekti i ndërsjellë marrin një rëndësi

të fundit /



Rrethi i vogël shoqëror nuk është gjithmonë vetmi: çfarë kuptimi...



Analiza e Maran pas fitores: U futëm 20 herë në zonë, Shqipëria...



Hallgrímsson korrigjon deklaratën për "gjenocidin" para...



Ngushtica e Hormuzit mbetet e mbyllur, Trump refuzon ofertë...



Kosova synon rezultat pozitiv në transfertën ndaj Austrisë



Protesta qytetare hyn në ditën e 120-të, kërkohet dorëheqja e...



Këmbimi valutor/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

me te maone, transmeton telegan.

Vitet na bëjnë më të kujdesshëm në zgjedhje

Në rini, rrethi i njohjeve zakonisht është më i gjerë. Shkolla, universiteti, vendi i punës, daljet dhe aktivitetet e ndryshme shoqërore krijojnë kontakte të shumta dhe japin përshtypjen se jemi vazhdimisht të rrethuar nga njerëz.

Megjithatë, me kalimin e kohës ndryshojnë edhe prioritetet. Për marrëdhëniet që nuk ofrojnë afërsi, siguri ose kënaqësi mbetet gjithnjë e më pak kohë, ndaj rrethi shoqëror shpesh ngushtohet natyrshëm.

Një ndryshim i tillë nuk tregon medoemos se personi është bërë i mbyllur ose joshoqëror. Shpesh ai tregon se individi ka mësuar të jetë më i kujdesshëm me njerëzit të cilëve u fal kohën dhe besimin.

Vlera e miqësisë nuk përcaktohet nga numri

Shumë njohje mund të krijojnë pamjen e një jete të pasur shoqërore, por një marrëdhënie e afërt kërkon më tepër sesa biseda të rastit apo dalje të përbashkëta.

Miqësia përfshin besimin, praninë dhe mbështetjen si në momentet e mira, ashtu edhe në ditët e vështira. Ajo sjell edhe sigurinë se mund të shfaqemi ashtu siç jemi, pa pasur nevojë të shtremi.

Për këtë arsye, një njeri me dy ose tre miq të afërt nuk është patjetër më pak shoqëror se dikush që njeh qindra persona. Një rreth i vogël mund të përmbajë marrëdhënie shumë më të forta dhe më kuptimplota.

Zhgënjimet na bëjnë t'u kushtojmë rëndësi veprimeve

Përvojat e vështira shpesh lënë pas mësimet më të rëndësishme. Përfundimi i një miqësie, tradhtia, humbja e besimit, problemet në punë, vështirësitë financiare dhe ndarjet emocionale mund të ndikojnë në mënyrën se si i gjykojmë njerëzit.

Pas situatave të tilla, shumë persona fillojnë të vlerësojnë më tepër atë që të tjerët bëjnë sesa atë që premtojnë.

Një sjellje e mirë nuk mjafton më për të fituar menjëherë besimin dhe çdo afërsi nuk shihet automatikisht si miqësi e vërtetë. Besimi ndërtohet më ngadalë dhe kërkon prova në kohë.

Më pak njerëz, por marrëdhënie më të rëndësishme

Kur dikush nuk harxhon më energji duke mbajtur gjallë lidhje sipërfaqësore, i krijohet më shumë hapësirë për njerëzit që kanë vërtet rëndësi.

Nevoja për njerëz nuk pakësohet domosdoshmërisht me kalimin e viteve; ajo që ndryshon është mënyra dhe kriteret me të cilat i zgjedhim ata.

Humbjet, zhgënjimet dhe vendimet e gabuara mund të na mësojnë të vendosim kufij, të mbrojmë kohën tonë dhe të mos vazhdojmë me çdo kusht marrëdhënie që na dëmtojnë.

Prandaj, një rreth i kufizuar miqsh nuk duhet parë medoemos si shenjë vetmie. Në shumë raste, ai është pasqyrim i mësimave që jeta na ka dhënë për njerëzit dhe marrëdhëniet.

Shtuar më 27.09.2026 08:49

Tags: [Miqësia](#), [Sokrati](#), [vetmia](#)



Horoskopi 27 Shtator/
Dashuri dhe debate,
zbuloni surprizat e yjeve...



Horoskopi 26 Shtator/
Dashuri dhe debate,
zbuloni surprizat e yjeve...



Ora dimërore në 2026, ja
data kur akrepat do të
zhvendosen një orë pas



Horoskopi 25 Shtator/
Dashuri dhe debate,
zbuloni surprizat e yjeve...



Horoskopi 24 Shtator/
Dashuri dhe debate,
zbuloni surprizat e yjeve...

Horoskopi 23 Shtator/
Dashuri dhe debate,
zbuloni surprizat e yjeve...

Horoskopi 22 Shtator/
Dashuri dhe debate,
zbuloni surprizat e yjeve...

Pse nevoja për t'u izoluar
në shtëpi gjithë ditën fsheh
më shumë sesa thjesht...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.